



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 912/Prot.

Tiranë, më 20 /09/2016

VENDIM

Nr. 61, datë 20 / 9 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesat nr. 912 Prot., nr. 913 Prot., dhe nr. 914 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale Lezhë, Sarandë, Shkodër me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuessit, nëpërmjet kërkesave të datës 15.07.2016 ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni, si më poshtë:

1. *Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, Lezhë, Sarandë, Shkodër me objekt "Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim". lloji i auditimit: "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare", për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012;*
2. *Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Drejtoritë kanë raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014, me shkresën nr.912/1 Prot., datë 02.09.2016 ka kërkuar nga Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale Tiranë, në cilësinë e Autoritetit Publik, të depozitojë brenda datës 09.09.2016 parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra "Res Publica".

Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale Tiranë, pas koordinimit me ALUIZNI-n Lezhë, Sarandë, Shkodër, me shkresën nr. 6367/1 Prot., datë 13.09.2016, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: "Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t për trajtimin e çështjes, ka komunikuar me Drejtorinë e ALUIZNI-t Lezhë, Shkodër dhe Sarandë të cilat kanë trajtuar rastet me shkresat nr. prot 2992/1, datë 06.09.2016; nr. prot1877/1,

datë 05.09.2016; nr. prot .1917/1, datë 05.09.2016". Nga Drejtoritë e ALUIZNI-t Lezhë, Shkodër dhe Sarandë është kthyer përgjigje duke mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe sqaruar ndër të tjerat se: "Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe rekomandimet e KLSH-së i përcillen institucioneve eprorë (MZHU, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t). Për përmbushjen e kërkesave tuaja ju sugjerojmë ti drejtoheni Kontrollit të Lartë të Shtetit si autoritet përgjegjës që harton raportin dhe e publikon atë sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica", përbën informacion publik. Në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".* Informacioni i kërkuar, bazuar në nenin 7 të ligjit të sipërcituar, pika 1, shkronja dh) *.....raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit, përfshihet në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Në këto kushte ky lloj informacioni duhet të ishte bërë publik në Programin e Transparencës së autoritetit.*

Gjithashtu, Komisioneri me urdhrin nr. 141, datë 20.05.2016 Për miratimin e udhëzuesit "Autoritetet Publike në zbatim të ligjit Për të Drejtën e Informimit", vlerëson se Autoritet Publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" konsiderohet organi/zyra qëndror(e). Përsa më sipër Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale është Autoriteti Publik përgjegjës për zyrën qëndrore dhe të gjitha Drejtoritë Rajonale në varësi të saj.

Për sa më lart, duke qenë se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" përbën informacion publik dhe ndodhet pranë Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, Tiranë, bazuar në nenin 2, pika 2 dhe nenin 7 shkronja "dh" e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe në respektim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, duhet bërë publik në Programin e Transparencës së këtij institucioni.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesat e Qendrës "Res Publica" ndaj Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale Lezhë, Sarandë dhe Shkodër, Komisioneri vlerëson se ankesat janë të bazuara në ligj dhe si të tilla ato duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", përfaqësuar nga Av. _____, nr. 912 Prot., nr. 913 Prot., dhe nr. 914 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale/ Drejtorive të ALUIZNI-t Lezhë, Sarandë dhe Shkodër, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, Lezhë, Sarandë, Shkodër me objekt "Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim", lloji i auditimit: "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare", për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012:
Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Drejtoritë kanë raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur), brenda datës 27.9.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 20.9.2016.

